



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS/ SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 372/11
377/11
378/11
381/11

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej **z. Hysni Hoxha-Kryetar, z. Ekrem Salihu - Referues dhe z. Tefik Sylejmani-Anëtar**, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K**” me seli në Deçan, OE “**N.P.N.T ÇLIRIMI**” me seli ne Prizren, OE “**N.N. R&RUKOLLI-SHPK**” me seli në Skenderaj dhe OE “**N.P.T TONI COM**” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509m**”, me Nr. të Prokurimit MI/11/48/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/ Ministria e Infrastrukturës , me datën 20.12.2011 mori këtë :

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PJESËRISHËM TË ANKESAVE TË OE: “JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K” DEÇAN, “N.P.N.T ÇLIRIMI” PRIZREN, “N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K” SKENDERAJ DHE “N.P.T TONI COM”PRISHTINË , NR. 372/377/378/381/11, TË DATËS: 24/25/29.11.2011. SI TË BAZUARA

I. Aprovohen, pjesërisht si të bazuara ankesat e OE “**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K**” nga Deçani, OE “**N.P.N.T ÇLIRIMI**” nga Prizreni, OE “**N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K**” nga Skenderaj dhe OE “**N.P.T TONI COM**” nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509m**”, me Nr. të Prokurimit MI/11/48/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/Ministria e Infrastrukturës.

II. Urdhërohet, Autoriteti Kontraktues/Ministria e Infrastrukturës, që aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509m**”, me Nr. të Prokurimit MI/11/48/511, ta kthej në **Ri-tenderim**, nëse Autoriteti Kontraktues ka edhe mëturje interes për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

IV. Operatorëve ekonomik ankues “**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K**”, “**N.P.N.T ÇLIRIMI**”, “**N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K**” dhe “**N.P.T TONI COM**”, konform nenit 118 pika 3 iu kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro).

ARSYETIM

Operatori ekonomik “**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K**” nga Deçani, OE “**N.P.N.T ÇLIRIMI**” nga Prizreni, OE “**N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K**” nga Skenderaj dhe OE “**N.P.T TONI COM**” nga Prishtina, si palë të pa kënaqura me datën 24/25/25/26.11.2011, kanë parashtruar ankesa me nr. të prot. 372/11; 377/11; 378/11 dhe 381/11 kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE “**BENI COM-SHPK&ESKAVATORI-SHPK**” Prishtinë-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509m**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/ Ministria e Infrastrukturës.

Operatori ekonomik “**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K**” nga Deçani pretendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së nr. 04/L-042 siç janë:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së – Barazia në trajtim – jodiskriminim;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Shkelje e nenit 60 të LPP-së - Kriteri për dhënie të kontratës.

Operatori ekonomik “**N.P.N.T ÇLIRIMI**” nga Prizreni, pretendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së nr.04 /L-042 siç janë:

- Shkelje e nenit 59 të LPP-së- AK-së na ka njoftuar lidhur me eliminimin me arsyetim se na mungon një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve, dhe se na mungon edhe një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e rrugëve apo sanimit të urave, ndërsa këto kushte nuk i plotëson as konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës.

- Shkelje e nenit 60 të LPP-së - ne si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë tender, kemi ofruar çmim më të lirë prej: 485,472.19€, në krahasim me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, pastaj ne kemi ofruar dëshmi se kemi kryer punë të ngjashme dhe se kemi ofruar garacion për realizimin e tillë.

Operatori ekonomik “**N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K**” nga Skenderaj- pretendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së nr.04/L-042 siç janë:

- Shkelje e nenit 6 të LPP-së- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Shkelje e nenit 7 të LPP-së – Barazia në trajtim – jodiskriminim;
- Shkelje nenit 27 të LPP-së- Dosja e Tenderit;
- Shkelje e nenit 51 të LPP-së- Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;
- Shkelje e nenit 58 të LPP-së- Hapja e Tenderëve;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Shkelje e nenit 60 të LPP-së –Kriteri për dhënie të kontratës.

Operatori ekonomik “**N.P.T TONI COM**” nga Prishtina- pretendon se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së nr.04/L-042 siç janë:

- Shkelje e nenit 6 të LPP-së- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Shkelje e nenit 7 të LPP-së- Barazia në trajtim – jo diskriminimi;
- Shkelje e nenit 51 të LPP-së- Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;
- Shkelje e nenit 56 të LPP-së- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Shkelje e nenit 64 të LPP-së- Dëshmitë e kërkesave.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509m**”, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore OE “**JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K**” nga Deçani, OE “**N.P.N.T ÇLIRIMI**” nga Prizreni, OE “**N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K**” nga Skenderaj dhe OE “**N.P.T TONI COM**” nga Prishtina.

Eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës të datës 12.12.2011, ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktivitet të prokurimit, nuk ka respektuar nenin 6,7, 51, 59 dhe 60 të LPP-së, andaj i rekomandon Panelit Shqyrtues që të aprovohen pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik ankues si dhe të urdhërohet AK-së që të ri tenderojë aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues-Ministria e Infrastrukturës përmes parashtresës me nr. të protokollit 372/377/378/381/11 të datës: 16.12.2011, e ka njoftuar PSH-në se nuk pajtohet me mendimin dhe konstatimin e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e ekspertizës së datës 12.12.2011, ku theksohen se AK-së qëndron pranë rekomandimit për shpërblim me kontratë “**BENI COM&ESKAVATORI**” për projektin “**Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë, L=8509m**”.

Operatoret ekonomik ankues “JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K”, “N.P.N.T ÇLIRIMI”, “N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K” dhe “N.P.T TONI COM”, kanë pranuar raportin e ekspertit shqyrtues me datën:13/14.12.2011, mirëpo të njëjtit nuk kanë parashtruar parashtrësia me shkrim pranë Panelit Shqyrtues përkitazi me raportin e ekspertit shqyrtues të datës: 12.12.2011.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 20.12.2011, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit Shqyrtues, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues “N.P.N.T ÇLIRIMI” z. Bekim Jahaj, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues “N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K” z. Ragip Behrami, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues “N.P.T TONI COM” z. Sylejman Berila , përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues“JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K”edhe pse është ftuar në seancën dëgjimore për arsye të pa njohura mungon, përfaqësuesi i AK-së z. Sami Haziri, si dhe eksperti shqyrtues, u prezantuan të gjitha provat, duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik ankues, raporti i ekspertëve shqyrtues si dhe përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertëve shqyrtues.

Gjatë seancës kryesore, Kryetari i Panelit Shqyrtues fjalën i’a dha përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankues “N.P.N.T ÇLIRIMI” z. Jahaj i cili deklaroj: qëndrojmë plotësisht pranë ankesës sonë dhe pas qasjes në dokumente zyrtare qëi kemi bërë lëndës, kemi vrejtë që OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka të njëjtat të meta si kompania jonë, ndoshta edhe ma shumë se ne. Në fund përfaqësuesi i OE ankues shtoi kemi kërkuar që lënda të kthehet ne ri-vlerësim, sepse jemi me çmim më të ulët që është kriteri kryesor për dhënie të kontratës sipas dosjes së tenderit.

Në vazhdim të seancës, Kryetari i Panelit Shqyrtues fjalën i’a dha përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankues “N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K” z. Behrami i cili deklaroj: nuk pajtohem me vlerësimin e komisionit vlerësues të AK-së, e as me mendimin e ekspertit shqyrtues për dy (2) arsye: konstatim se na mungon një (1) inxhinier i ndërtimtarisë me tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit nuk është e vërtetë, pasi që ne kompani jemi dy (2) inxhinier me më shumë se tri (3) vite përvojë pune,z. Ragip Behrani dhe z.Jakup Tahiri, të gjitha provat dhe dokumentet siç janë: diploma, CV-it, kontrata e punës, për këta dy (2) inxhinier i’a kemi bashkangjitur ofertës dhe mendojmë se dikush prej AK-së të gjitha këto dokumente i ka hequr nga dosja origjinale. Pikërisht për këtë arsye kërkoj nga Kryetari i Panelit Shqyrtues të formoj komision për hapjen e kopjes rezervë të ofertës sonë.

Sa i përket konstatimit të ekspertit shqyrtues se mungojnë procesverbalet e pranimit teknike të punëve dhe referencat, përfaqësuesi i OE ankues theksoj se ofertës i’a ka bashkangjitur kontratat e punës dhe procesverbalet e pranimit teknik me të gjitha AK-së ku kanë punuar, dhe se këto referenca janë të mjaftueshme për kërkesat e dosjes së tenderit të AK-së. Në fund z. Behrami shtoi se lidhur me certifikatat e auditimit të cilat i ka kërkuar AK-së, nuk e di pse auditori i ka lënë pa i vulosur këto pasqyra financiare, përndryshe këto pasqyra janë reale dhe mban përgjegjësi për këtë që deklarom.

Kryetari i Panelit Shqyrtues fjalën i'a dha edhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankues "N.P.T TONI COM" z. Berila i cili theksoi: ne nuk jemi pajtuar me konstatimin e AK-së se jemi të pa përgjegjshëm, për arsye se pretendimet e AK-së nuk qëndrojnë, sepse oferta jonë është e përgjegjshme si në aspektin administrativ po ashtu edhe në aspektin teknike dhe profesional në harmoni të plotë me kriteret e kërkuara nga AK-së në dosjen e tenderit. Në fund përfaqësuesi i OE ankues kërkoj nga PSH-së që të bëhet hapja e kopjes rezervë të ofertës , për të vërtetuar se kanë fakte, fjala është për dokumentet për Menaxherin e projektit, personelin teknik, mungon CV, diploma, kontrata e punës, të cilat i kanë dorëzuar bashkë me ofertë, por çuditërisht ato nuk gjinden në ofertën origjinale.

Në vazhdim të seancës Kryetari i Panelit Shqyrtues fjalën i'a dha përfaqësuesit të AK-së z. Haziri i cili deklaroj: si komision vlerësues kemi të drejtë të vlerësojmë ofertat në bazë të origjinalit dhe kemi bërë vlerësimin për dy (2) kompanitë ankuese në bazë të origjinalit. Pretendimet e OE ankues "N.P.N.T ÇLIRIMI" janë të pa qëndrueshme dhe i mbrojmë arsyet për eliminimin e tij, të cilat për afërsisht përputhen me ekspertizën e ekspertit shqyrtues.

Përfaqësuesi i AK-së pohoi se OE "N.P.N.T ÇLIRIMI" dhe OE "N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K", kanë ofertuar me të njëjtin inxhinier të gjeodezisë dhe ky inxhinier është z. Rustem Bekaj, po ashtu pretendimi se ka tërheqje të dokumentacionin është i pa qëndrueshëm. OE "N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K" pretendon se posedon me procesverbalin e pranimit teknik për projektet në ndërtimin e rrugëve dhe urave në tri (3) vitet e fundit , si dhe posedon dyfishin e vlerës së ofertës, gjë që këto dëshmi në tërësi nuk i posedon në ofertën e ofruar edhe pse dyfishi i vlerës së ofertës është llogaritur ndërtimi i lartë, por kjo nuk merret parasysh nga AK-së pasi që ndërtimi i lartë nuk bën pjesë në punë të ngjashme me ndërtimin e rrugëve dhe urave dhe nuk sjellë dyfishin e vlerës së ofertës, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Përfaqësuesi i AK-së lidhur me pretendimet e OE ankues "N.P.T TONI COM" , shtoi përveç asaj që është potencuar në raportin e vlerësimit të AK-së dhe për afërsisht nga eksperti shqyrtues, kompania posedon pasqyra financiare për vitin 2008, 2009, 2010 dhe 2011 nuk qëndron, sepse është jo profesionale që brenda vitit fiskal të kërkojnë pasqyrat financiare dhe auditimi prej një firme të licencuar, pra ne si AK-së kemi kërkuar që këto pasqyra financiare të jenë për tri (3) vitet e fundit 2008, 2009 dhe 2010. Në fund përfaqësuesi i AK-së z. Haziri edhe njëherë përsërit kundërshtimin e AK-së lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës së datës 12.12.2011, duke ofruar argumente për vendimin e marrë nga komisioni i vlerësimit.

Kryetari i Panelit Shqyrtues faljen i'a dha ekspertit shqyrtues i cili deklaroj: të gjitha konstatimet e bëra në ekspertizë janë të qëndrueshme dhe qëndrojnë prapa atyre konstatimeve. Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të AK-së, kam konstatuar se raportin e auditimit OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk është i vëltuar nga një firmë e licencuar nga një firmë e auditimit, psh. OE "Eskavatori" ka të nënshkruar vetëm faqen e parë ku nuk figurojnë të dhëna me të hyrat apo daljet, eventualisht borxhet për atë periudhë, ndërsa pasqyrat financiare nuk janë të vëltura nga auditori ligjor.

Eksperti shqyrtues pohoi se menaxheri i projektit i OE fitues z. Nuhi Nuhiu, ka një kontratë mbi veprën, mirëpo mungon autorizimi apo vendimi i konzorciumit për caktimin e këtij personi si projekt menaxher për këtë projekt. Po ashtu në nenin 9.2 të dosjes se tenderit, të cilën gjë nuk e potencoi përfaqësuesi i AK-së shkruar shumë qartë *“për menaxherin e projektit-udhëheqësi e punishtes , personelin kryesor teknik, të paraqiten: CV-të, diplomat përkatëse, kontrata e punës dhe letra referenca për punët e mëparshme nga punëdhësit e tyre në lëmin e ndërtimit të rrugëve dhe urave”*, konzerciumi rekomanduar për dhënie të kontratës për projekt menaxherin ka ofruar vetëm një CV-i e cila nuk është as e vulosur , as e nënshkruar nga askush, që për mendimin tim është dëshmi e pavlefshme, gjë që ky fakt e bënë të papërgjegjshëm konzorciumin “BENI COM & ESKAVATORI”. Eksperti shqyrtues në vazhdim potencon edhe faktin tjetër, që në dosjen e tenderit neni 9.1 AK-së ka kërkuar *“një deklaratë mbi fuqinë mesatare punëtore të OE dhe numrin mesatar të personelit menaxherial për secilin nga tri vitet e fundit”* gjë të cilin konzerciumi i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar këtë deklaratë, që është një fakt shtesë që ky konzercium është i pa përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues potenconi se OE “Famis Co” i shpallur i përgjegjshëm nga AK-së njësoj si OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i ka vërtetuar-vulosur pasqyrat financiare me të dhëna konkrete nga zyrtari ligjor i auditimit. Po ashtu edhe OE “Victoria Invest” i shpallur i përgjegjshëm nga AK-së nuk posedon pasqyra financiare të vulosura për vitin 2008, dhe këtu mund të marrim si shembull se kjo kompani për vitin 2009 dhe 2010 i ka të vulosura dhe të nënshkruara këto pasqyra financiare nga zyrtari ligjor i auditimit.

Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues ku theksohet AK-së ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet i tillë është i qëndrueshëm për faktin, se Autoriteti Kontraktues duhet të merrë masa te nevojshme me qëllim te sigurimit të pjesëmarrjes sa me te gjere te mundshme te operatoreve ekonomik ne perputhje me qellimin e prokurimit duke analizuar edhe kriteret e perzgjedhjes.

Sa i përket pretendimeve të operatorëve ekonomik ankues, se AK-së ka bërë shkelje të nenit 59 dhe 60 të LPP-së, Paneli Shqyrtues bazuar ne të gjeturat e ekspertit shqyrtues, sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, si dhe në bazë të nenit 59 pika 4 të LPP-së konstaton se një OE pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit është i përgjegjshëm vetëm nëse i ka plotësuar kërkesat e përzgjedhjes dhe specifikimit teknik të kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa në rastin konkret operatorët ekonomik që kanë tenderuar ne këtë aktivitet të prokurimit nuk i kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të specifikuar ne njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit nga AK-së.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar ne faktet e lartcekura si dhe në konstatimet e ekspertit shqyrtues në raportin e ekspertizës, konstaton se Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka respektuar nenin 32 pika 4 të LPP-së ku ceket citat “Nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, Autoriteti Kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit” mbarim i citatit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesve të ankesave të cilat u vlerësuan si të qëndrueshme, deklaratave të përfaqësuesve të OE ankesë, deklaratës së përfaqësuesit të AK-së, si dhe sqarimeve të dhëna nga ana e ekspertëve shqyrtues gjatë seancës dëgjimore, konstatoj se AK-së ka bërë shkelje të nenit 32.4, 59 dhe 60 të LPP-së, në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ato siç u tha si me lartë, vlerësoj se ankesat e operatorëve ekonomik “JOOS&KRASNIQI-BAZE-SH.P.K” nga Deçani, “N.P.N.T ÇLIRIMI” nga Prizreni, “N.N. R&RUKOLLI-SH.P.K” nga Skenderaj dhe “N.P.T TONI COM” nga Prishtina, janë pjesërisht të bazuara, kështu që vendosi si në dizpozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mundë të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesëpadi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

